

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

21.01.2025  
Ora 12:05

**RENDI I DITËS**

**“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën  
11 janar – 18 janar 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj.**
- **Parti Politike:**      **PD (z.F. Nuri), PL (z. K. Kolndreu)**
- **Të tjerë:**      **KRIIK, Qëndresa Qytetare**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi për shqyrtim në rend dite:

- Vlerësimin e raportimit e institucioneve publike, për veprimtaritë me karakter publik për periudhën 11 Janar - 18 Janar 2025”.

- Si dhe dy denoncime të paraqitura nga organizata “Qëndresa Qytetare” ndaj disa institucioneve në lidhje me parregullsi të pretenduara nga ana e kësaj organizate, për këto institucione, në lidhje me veprimtarinë publike.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me raportin për veprimtaritë publike për periudhën 11 Janar -18 Janar 2025. Po zonja Doçaj!

**Znj. P. Doçaj:** Faleminderit! Në lidhje me informacionin, një përmbledhje të raportimeve të veprimtarive publike në ndërfaqen elektronike NRI për periudhën 11 Janar - 18 Janar. Kemi 135 institucione publike të regjistruara në ndërfaqen

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

elektronike NRI dhe që kanë akses për raportimin e këtyre veprimtarive. 320 raportime janë kryer në total në këtë periudhë kohore. 294 postime janë aktive dhe 15 janë të ndaluara. Rezulton se 11 veprimtari janë anuluar nga vetë institucioni. Në datën 13 dhe 14 janar ka pasur në total 47 veprimtari jashtë afatit 5 ditor të raportimit, por pa statusin e ndalimit për shkak të disa problemeve teknike dhe përditësimit në modulën e ri të raportimit, të cilat janë zgjidhur me pas. Në datën 13 dhe 14 janar kemi pasur 23 raportime të ndaluara automatikisht nga sistemi NRI. Gjithmonë për raportim jashtë afatit 5 ditor nga të cilat 8 veprimtari i është hequr shënimi i ndaluar pasi kishin raportuar paraprakisht në adresën e email pa krijuar ende aksesin në portalin NRI dhe janë konsideruar si veprimtari të cilat janë raportuar brenda afatit. Kemi kërkuar sqarimin nga disa institucione ku iu kemi shkruar në lidhje me saktësimin e tyre të raportimit dhe u kemi cituar gjithashtu se duhet të jenë të vëmendshëm në raportimin e javëve të tjera pasi do të aplikohen sanksione dhe masa administrative në rast se këto veprimtari janë të pa plota apo do të raportohen jashtë afatit. Kjo është një përmbledhje në lidhje me numrin e raportimeve dhe me mënyrën se si kanë raportuar.

**Z. I. Celibashi:** E vetmja problematike që konstatohet për këtë periudhë është vonesa në raportim, të disa veprimtarive duke mos respektuar afatin pesë ditor. Mirë në rregull po e konsiderojmë të përligjur deri diku të themi pretendimin e tyre pasi për periudhën nga 11 janari, edhe pse detyrimi i tyre ka filluar që në datën 6 janar. Kështu që nga data 11 janar deri në 16 janar, të gjitha ato veprimtari të cilat nuk janë raportuar brenda afatit, po konsiderojmë një lloj amnistie. Por për këdo veprimtari e cila daton e zhvilluar pas datës 16 janar do të duhet të vendosim sanksione administrative, për veprimtari që lidhen pas datës 16 Janar. Po do ta shohim dhe në seancën tjetër do ta vendosim.

**Vendimi nr. 25**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**21.01.2025  
Ora 12:10**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 1, datë 13.01.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj.**
- **Parti Politike:**      **PD (z.F.Nuri), PL (z. K. Kolndreu)**
- **Të tjerë:**      **KRIIK, Qëndresa Qytetare**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, kalojmë me pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit numër 1 të “Qëndresës Qytetare” ndaj Kryetarit të Bashkisë Kamëz.

**Znj. P. Doçaj:** Subjekti i denoncuar është zoti Rakip Suli kryetati i Bashkisë Kamëz. Objekti i denoncimit është konstatimi i përdorimit të burimeve publike për qëllime zgjedhore. Kemi pretendimet e denoncuesit të cilët theksojnë se : “Më datë 11 janar 2025, në ambientet e Bibliotekës së Kamzës është zhvilluar një takim i përfaqësuesve të Partisë Socialiste, ku është përfshirë zoti Rakip Suli, kryetar i bashkisë, znj. Elisa Spiropali, znj. Lindita Nikolla. Ky takim sikurse rezulton nga postimet në faqet zyrtare të disa pjesëmarrësve është kryer për qëllime zgjedhore. Kjo për sa i përket pretendimit të denoncuesit. Nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në datën 16 janar është marrë një vendim ku është vendosur fillimi i një hetimi administrativ. Në kuadër të hetimit administrativ, nëpërmjet adresës së postës

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

elektronike, i është drejtuar personit përgjegjës për raportimin ku ju kërkua të paraqesë prapësimet që mund të ketë në lidhje me objektin e denoncimit, duke i'u parashtruar edhe disa pyetje: Kush e menaxhon Bibliotekën e Bashkisë Kamëz? Statusi që ka kjo bibliotekë dhe, kush është organizatori i këtij eventi? Personi përgjegjës ka sjellë pretendimet dhe ka rezultuar në bazë të pretendimeve të tyre që: Kjo është një qendër që vihet në dispozicion të organizatave me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Çdo palë e interesuar merr miratimin nga Drejtori i Qendrës së Kulturës. Përfaqësuesi i Kuvendit Rinor Kamëz i është drejtuar me shkresë Qendrës së Kulturës, me qëllim vënien në dispozicion të kësaj salle, për zhvillimin e aktivitetit të datës 11.01.2025. Është administruar nga ana jonë kjo shkresë në formën e provës, kthimi i përgjigjes së Kryetarit të Bashkisë Kamëz. Gjithashtu ka rezultuar nga hetimi nëpërmjet komunikimit elektronik që Qendra e Kulturës është drejtori e Bashkisë Kamëz, të cilën e ka në administrim Pallati i Kulturës “Artan Cuku”. Drejtor i Qendrës së Kulturës është Zonja Rigelca Gupe. Kjo për sa i përket hetimit të kryer dhe pretendimit të denoncuesit dhe pretendimet e palës së denoncuar. Janë njoftuar të gjithë për pjesëmarrje dhe ditën e sotme nuk është paraqitur asnjë person as personi përgjegjës, as ndonjë person i autorizuar prej tyre. Por ka ardhur vetëm denoncuesi.

**Z. I. Celibashi:** Ka ardhur dikush, përfaqësues nga Bashkia Kamëz? Po! Ju lutem, dikush t'i lirojë vendin, të afrohet! Keni një autorizim? Dakord! Emër, mbiemër ju lutem!

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Unë jam Enkeleda Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz, jemi njohur me denoncimin që ka bërë organizata “Qëndresa Qytetare”. Pretendimi që kemi parashtruar në lidhje me këtë denoncim i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

referohen, sepse nuk jemi përpara një veprimtarie me karakter politik, që nuk është në kuadër të zgjedhjeve. Shkresa që ju kemi depozituar konkretisht rregullorja e Pallatit të Kulturës nuk është Biblioteka e Kamzës por është salla e rinisë. Kuvendi rinor përbëhet nga të rinjtë e Kamzës, ku kishte një skaletë që kishte të bënte me aktivitete kulturore që kishte të bënte me artin, punësimin, arsimin dhe këto gjëra. Pra, asnjë element i këtij aktiviteti nuk binte në kundërshtim me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator dhe me Kodin Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Keni diçka tjetër?

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Jo, kaq kemi!


**Z. I. Celibashi:** Pra, ju po thoni që aktiviteti që është zhvilluar nuk është aktivitet politik, nuk ka qenë aktivitet me përmbajtje politike dhe elektorale.

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Po, nuk ka qenë aktivitet me përmbajtje politike dhe elektorale. Përsa i përket fotove që janë depozituar aty ka ndodhur një keqkuptim sepse organizata socialiste nuk korrespondonte me grupin e të rinjve që kanë qenë në sallën e rinisë. Pra, janë dy gjëra krejt të ndryshme. Thjesht ka pasur një mbivendosje në momentin që janë publikuar dhe ajo veprimtari nuk ka pasur fare karakter politik. Ju kemi depozituar, ju kërkoj ndjesë, edhe skaletën me të cilën të rinjtë kanë komunikuar se për çfarë kanë diskutuar dhe për çfarë ka qenë prezent kryetari i Bashkisë Kamëz.

**Z. I. Celibashi:** Këto janë pretendimet tuaja?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

*Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz: Po.*

*Z. I. Celibashi: Dakord! Po përfaqësuesi i Qëndrës Qytetare dëshiron të thotë diçka?*

*Z. Dh. Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresa Qytetare: Dhimitër Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresës Qytetare. Së pari, një pyetje për zonjën, përpara se të vazhdojmë me parashtrimet. Ju jeni përfaqësuese e Bashkisë Kamëz apo e Partisë Socialiste?*

*Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz: Përfaqësuese e institucionit.*

*Z. Dh. Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresa Qytetare: Në rregull, si duket përfaqësuesja e institucionit njeh edhe përfaqësuesit e Partisë Socialiste, është gjë interesante kjo. Gjithashtu në vijim të të gjithë gjërave, në vijim të parashtrimeve të Qëndresës Qytetare dhe në vijim të denoncimit që ne kemi bërë. Së pari, provohet që është në ambientet e bibliotekës, sepse vetë të gjithë pjesëmarrësit, qoftë nga zoti Rakip Suli, por dhe të hysh në faqen e bibliotekës së Bashkisë Kamëz, fotot përputhen të gjitha të dhënat dhe elementët e ambientit. Përsa i takon faktit që kemi të bëjmë me një takim rinor ku zhvillohet për kulturën, në dijeninë time, për herë të fundit nga leximi i Kushtetutës, kryetari i Kuvendit nuk ka ndonjë përgjegjësi në lidhje me kulturën veçanërisht në një zonë të caktuar zgjedhore. Megjithatë të gjitha postimet flasin që kemi të bëjmë me një Kuvend Rinor. Nga të gjitha informacionet që janë regjistruar nga Qëndresa Qytetare, denoncimet që kanë ardhur pranë nesh, rezulton se Kuvendi Rinor është një organ i Partisë Socialiste që lidhet me Forumin Rinor European Socialist të Shqipërisë. Pra, në çdo qark ka një Kuvend Rinor dhe Kuvendi Rinor gjithashtu, funksionon pranë njësive administrative të qeverisjes vendore dhe bëhen mbledhje në 12 qarqe. Ky takim që është zhvilluar në ambientet*

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

e bibliotekës së Bashkisë Kamëz është zhvilluar për qëllime të pastra zgjedhore, sepse të paktën në denoncimet që ne kemi nga përfaqësuesit e Kuvendeve Rinore më pas do të zgjidhen në Kuvendin Rinor Kombëtar të Partisë Socialiste, prej nga aty mund të përzgjidhen edhe disa prej kandidatëve potencialë për deputet, në listat e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kështu që është e qartë që kemi të bëjmë me një organizim tërësisht politik që është bërë për qëllime zgjedhore, që provohet që jemi përballë një ambienti publik qoftë pallat kulture, qoftë bibliotekë çfarë do që të jetë. Kodi Zgjedhor është i qartë, mjafton që kemi të bëjmë me një aset publik që të vendoset në dispozicion të një partie ose të një subjekti zgjedhor dhe në këtë rast konstatohet shkelja. Pra, nuk ka rëndësi nëse kemi të bëjmë me një bibliotekë apo një pallat kulture, në vetvete është një aset publik. Për rrjedhojë, plotësohen të gjitha kushtet, qoftë në referim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, qoftë në referim të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, për konstatimin e shkeljes administrative nga ana e kryetarit të Bashkisë Kamëz, zotit Rakip Suli. Në të njëjtën kohë duke i'u referuar edhe vendimeve të KAS-it, edhe nga ana e Partisë Socialiste, sepse është subjekti që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ka përfituar nga vënia në përdorim e burimeve publike. Faleminderit!

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Faleminderit shumë! Ju të gjithë denoncimin e mbështesni mbi një aludim që mendoni se aty është diskutuar për procesin zgjedhor apo për veprimtari politike. Unë me anë të shkresës që na është vënë në dispozicion, e gjithë skaleta nuk ka të bëjë fare me një veprimtari politike. Për aq kohë sa nuk jemi përpara kësaj veprimtarie, nuk mund të ndëshkohemi apo të bëhet një hetim administrativ, sepse nuk mund të arrish në një pretendim mbi prova. Ju pretendoni që është veprimtari politike dhe unë pretendoj që nuk është, sepse skaleta ka një objekt komplet ndryshe nga procesi zgjedhor.


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresa Qytetare:** Ndjesë të nderuar, mund të jetë e vërtetë ndoshta, por aludimet tona nuk bazohen në shpikje që Qëndresa Qytetare ka bërë, apo monitoruesit e vet, por bazohet vetëm në deklaratimet e të gjithë pjesëmarrësve në këtë takim. Pra, kemi zonjën Elisa Spiropali, “me organizatorë të Kuvendit Rinor Kamëz...”, si dhe të cilat janë edhe në provat e depozituara “... shtohet motivimi dhe frymëzimi për të vazhduar ndryshimet epokale”. Gjithashtu dhe fjali të tjera që lidhen me procesin zgjedhor që kujtojnë edhe reminishenca të së kaluarës. Gjithashtu zonja Lindita Nikolla, “krenar për Shqipërinë”, “vetëm përpara”, “Shqipëria 2030”, “takim me të rinjtë dhe të rejtat e Kamzës, me organizator të Kuvendit Rinor të Partisë Socialiste”. Janë të gjitha elementë që provojnë që qendra, ambienti publik çfarë do që të jetë, është vënë në dispozicion të një subjekti zgjedhor, në një periudhë që është e ndaluar dhe kemi të bëjmë me shpërdorim detyre. Të tjerat, janë thjesht pretendime të cilat nuk bazohen në fakte. Faleminderit!

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Për herë të fundit, faleminderit! Atëherë, e nisa duke thënë: “aludimin e mbështes mbi një deklaratë që kam bërë në rrjetet sociale”. Por, unë si fillim parashtrova që fotoja e parë që përkon me organizatën socialiste nuk është e njëjta me subjektet, me të rinjtë, që janë në foton e bibliotekës. Nëse ti po më thua që në ambientin e Bashkisë Kamëz është një organizatë socialiste. Atëherë, kjo organizatë është ndryshe nga grupi që është përdorur nga të rinjtë e Kuvendit Rinor brenda Pallatit të Kulturës, e theksoj dhe jo brenda bibliotekës që e ka Bashkia Kamëz. Që do të thotë ajo që është përpara nuk korrespondon me të rinjtë që janë në kahun tjetër. Janë dy pamje që janë të bashkuara në një album por nuk kanë të bëjnë, sepse skaleta që ka të bëjë me bibliotekën ka

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*


komplet fushë tjetër. Kjo është komplet ndryshe, që është i njohur Bashkia Kamëz, është miratuar nga drejtoresha e Pallatit të Kulturës, sepse edhe rregulloria e brendshme e Pallatit të Kulturës ka të bëjë që të rinjtë e Kamzës mund të mblidhen për të diskutuar. Pjesëmarrja, meqë e theksuat, e Kryetares së Kuvendit ka të bëjë, sepse të rinjtë do të propozonin, edhe skaleta thotë, disa projekte idesh në lidhje se si do të ndikonte punësimi, arësimi. Çfarëdolloj propozimesh do të bëheshin, konkretisht ishin disa sisteme dualiste që provoheshin që kishin të bënin me projektvendime apo projektligje që do të duhej të miratoheshin. E gjithë kjo fushë objektive, nuk ka të bëjë fare me procesin zgjedhor dhe ne duke qenë se në atë periudhë nuk përkonte me detyrimin për ta raportuar. Kjo ishte një arsye që edhe Bashkia Kamëz nuk e raportoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sepse është përpara datës 9 janar, pavarësisht se kur është publikuar në rrjetet sociale.

**Z. I. Celibashi:** E fundit, përfaqësuesja e Bashkisë Kamëz mesa kuptova unë, pretendon që ai aktivitet nuk përputhet me pamjet... Janë dy aktivitete të ndryshme mesa kuptova unë. Qenka zhvilluar edhe një aktivitet politik që është me përfaqësues të Partisë Socialiste të një organizate të Partisë Socialiste....

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Që mund të korrespondojnë edhe personat. Por ideja është që e mira publike dhe objekti i Bashkisë Kamëz nuk është përdorur për atë funksion..

**Z. I. Celibashi:** Një sekondë, të lutem! Nëse janë të njëjtët persona por ju thoni që janë dy aktivitete dhe këta të njëjtët persona kanë qenë në dy cilësi të ndryshme, këtë jeni duke thënë apo jo? Apo janë dy aktivitete të ndryshme që kanë qëlluar që në njërin prej tyre...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Pikërisht këtë po them. Janë dy aktivitete të ndryshme. Tani ideja është për çfarë është përdorur e mira publike dhe unë këtë po kundërshtoj. Që e mira, siç e thotë vendimi nr. 9 ose një objekt që është nën pronësinë e Bashkisë Kamëz, ose të një administrate shtetërore nuk ka pasur këtë funksion, që është veprimtari politike.

**Z. I. Celibashi:** E fundit, përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare!

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresa Qytetare:** Për të hedhur poshtë edhe këtë pretendim, megjithatë vërehet edhe nga fotot të cilat janë depozituar, ndoshta telefoni nuk mund të verifikohet, por mund ta shohim bashkë me përfaqësuesen e bashkisë. Kemi të bëjmë me të njëjtin person po marrim vetëm një person këtu, që është personi me pallton bezhë dhe tani po bëhemi ndoshta dhe shumë qesharakë dhe detajist, por duke qenë se pretendimet janë qesharake duhet të biem ndoshta edhe ndonjëherë në këtë nivel. Është i njëjti person që vërehet këtu, pra është i njëjti person, po marr të njëjtin person specifik nuk po marr të gjithë personat, sepse nëse bëhet rakordimi përkojnë, është bërë ky rakordim më herët. Sërish është i njëjti person edhe këtu në të njëjtën foto, kështu që bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet, të njëjtët pjesëmarrës që është qëllimi politik pa diskutuar dhe shtuar diçka tjetër. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë çështje, keni për të thënë diçka? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

**Z. F. Nuri përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar Komisioner! Ne duhet të mbajmë një qëndrim si parti politike, si Parti Demokratike dhe si opozitë në tërësi

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

duke nisur edhe nga rasti i parë që po vjen sot për tu shqyrtuar. Jemi në mbështetje të fortë të denoncimeve të kryera pranë KQZ-së nga Qëndresa Qytetare dhe nga të gjitha organizmat e tjerë që janë për vëzhgimin dhe monitorimin e proceseve zgjedhore. Ne gjykojmë se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të jetë i ashpër në lidhje me të gjitha këto raste ku katër muaj përpara zgjedhjeve e theksojmë, është totalisht e ndaluar të përdoren dhe të keqpërdoren funksione publike, asete, burime publike të administratës shtetërore dhe publike në tërësi, në funksion direkt apo indirekt të proceseve zgjedhore dhe procesit të 11 majit 2025 në Shqipëri. Ekzistojnë denoncime të shumta që kanë ardhur qoftë në KQZ, qoftë tek ne si parti politike, apo edhe janë bërë publikisht në media, apo në rrjetet sociale ku keqpërdoret fatkeqësisht administrata publike. Punonjësit e administratës publike detyrohen të marrin pjesë në aktivitete të tilla, sikundër mund të jetë edhe rasti konkret objekt shqyrtimi që ju duhet të gjykoni. Por ne, na vijnë edhe denoncime të minutës së fundit dhe nga rrjetet sociale. Marr shkas që ta bëjë me dije një rast të fundit, ku hyn në kategorinë e atyre rasteve, që administrata detyrohet në një farë mënyre të postojë, të bëjë shpërndarje, të pëlqejë postime të ndryshme, të cilat mund të jenë të institucionit të caktuar në rrjetet sociale të institucionit, por që mbajnë atë dualitetin midis partisë në pushtet dhe funksionit publik. Kemi një denoncim publik që na është bërë me dije, që është shpërndarë në një rrjet social mjaft të ndjekur nga shqiptarët që ka të bëjë me institucionin e “Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime” AKUK. Ku ka të dhëna të publikuara publikisht, që drejtori i këtij institucioni në një farë mënyre, detyron stafin për të shpërndarë postimet në rrjetet sociale. Ka ngritur edhe një strukturë sipas denoncimit publik të bërë, që kontrollon nëse stafi i këtij institucioni i ka kryer apo jo këto shpërndarje po themi. Prandaj të tilla raste janë të pa tolerueshme dhe do të donim një qëndrim të fortë nga KQZ që në fillim, që të shërbejë si mësim edhe për rastet e tjera të mos përsëritet më. Jemi në vitin 2025 nuk

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

mundet që të detyrohet admonistrata të merret politikë gjatë orarit zyrtar.  
Faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Diskutime të tjera? Nuk kemi! Keni dokumente, prova të tjera secila prej palëve për të depozituar?

**Z. Dh. Zguro, përfaqësues ligjor i Qëndresa Qytetare:** Jo janë të gjitha provat e depozituara.

**Znj. E. Lama, përfaqësuese e Bashkisë Kamëz:** Janë të depozituara në email.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Faleminderit për të gjithë kontributet tuaja, e përfundojmë shqyrtimin administrativ dhe vendimin në lidhje me këtë çështje ditën e premtë të kësaj jave do t'ju njoftojmë për orën.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

21.01.2025  
Ora 12:27

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 2, datë 14.01.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj.**
- **Parti Politike:**      **PD (z.F.Nuri), PL (z. K. Kolndreu)**
- **Të tjerë:**      **KRIIK, Qëndresa Qytetare**

**Lista e pjesëmarrësve, bashkëlidhur procesverbalit.**

**Z. I. Celibashi:** Mirë kalojmë tek çështja tjetër. Denoncimi nr. 2, po i Qëndresa Qytetare. Po Pavlina!

**Znj. P. Doçaj:** Qëndresa Qytetare ka depozituar një denoncim i cili ka marrë numrin 2, në regjistrin e denoncimeve. Subjektet e denoncuar janë 16 shkolla, 13 zyra arsimore vendore të arsimit parauniversitar, 4 drejtori rajonale të arsimit parauniversitar dhe drejtorë të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar. Objekti i denoncimit ka të bëjë me konstatimin e përdorimit të burimeve publike nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale. Në lidhje me pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me përdorimin e faqes zyrtare të institucionit të arsimit parauniversitar, të zyrave vendore të arsimit si dhe të faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të cilat janë angazhuar në forma të ndryshme duke përfshirë pëlqimin, komentimin, apo shpërndarjen të postimeve që kanë në përbërje të tyre

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

thirrje elektorale në faqet zyrtare të këtyre institucioneve. Nëpërmjet vendimit nr. 21, datë 16.01.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur nisjen e hetimit administrativ në lidhje me këtë denoncim. Në kuadër të këtij hetimi, në adresë të postës elektronike i jemi drejtuar të gjithë personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në zyrat vendore të arsimit parauniversitar, duke ju kërkuar që të paraqesin prova në lidhje me objektin e denoncimit. Kanë paraqitur prova dhe pretendime të gjitha ZVAP-të. Pak a shumë kanë të njëjtat pretendime ku ka të bëjë me ngatërresën që kanë në llogaritë personale me atë të përdorur për çështje pune. Të gjithë garantojnë se pas njoftimit janë fshirë menjëherë këto pastime apo like-t që kanë bërë në këto postime. Kemi marrë pretendime nga të gjitha zyrat e arsimit parauniversitar, të cilat theksojnë se në faqet zyrtare të këtyre zyrave nuk është hedhur asnjë postim. Gjithashtu garantojnë që nuk është hedhur asnjë postim dhe duke qenë se kanë në varësi të 16 shkollat që janë objekt i këtij denoncimi, kanë garantuar që ka qenë hera e fundit që bëjnë like apo postime në faqet e tyre zyrtare duke u justifikuar, se ka të bëjë vetëm me ngatërresën e llogarive personale me atë zyrtare. Janë njoftuar dhe janë pothuajse, të gjithë prezent të marrin pjesë në seancën e sotme publike dhe kanë parashtruar edhe pretendime për objektin e denoncimit.

**Z. I. Celibashi:** Po përfaqësuesi i Qëndresës ka për të shtuar diçka më shumë?

**Z. Dh. Zguro, jurist Qëndresa Qytetare:** I nderuar në lidhje me atë që duam ne të shtojmë, duke mbajtur në konsideratë, që pjesa më e madhe e postimeve janë fshirë, megjithatë provat janë depozituar. Ndonëse disa prej drejtorive rajonale arsimore të arsimit parauniversitar apo ZVA-të kanë deklaruar se ato vetë nuk kanë shpërndarë ndonjë postim. Një nga detyrat e tyre kryesore lidhet me verifikimin e ligjshmërisë të funksioneve të institucioneve të tyre të varësisë, që lidhen kryesisht me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

institucionet arsimore. Megjithatë ka raste si ZVA-ja e Krujës siç po shihja një nga provat, që janë angazhuar në forma të ndryshme me postime që kanë lidhje me përmbajtje elektrorale. Gjëja e vetme që Qëndresa Qytetare do të donte të shtonte siç është fakti që kemi përmendur edhe në denoncimin tonë, që kemi të bëjmë me një angazhim në mënyrë sistematike, pra nuk kemi të bëjmë vetëm me një, apo dy postime. Nga data 11 janar deri më sot Ministria e Asimit dhe Sporteve, Ogerta Manastirliu, mund të ketë bërë mbi 12 postime me përmbajtje elektorale ku institucione të ndryshme arsimore vazhdojnë të angazhohen. Një nga rastet më flagrante, po e marr si shembull është një nga shkollat në juridiksionin e Drejtorisë Parauniversitare Rajonale Lezhë, shkolla Migjeni në Mamurras, ku është shpërndarë pamje nga Kuvendi Rinor i Partisë Socialiste. Megjithatë duke qenë se kemi të bëjmë me një angazhim sistematik të institucioneve shtetërore për të shpërndarë postime të titullarëve të tyre, që janë postime tërësisht me përmbajtje politike, duke mbajtur në konsideratë edhe precedentin e zgjedhjeve të vitit 2023, Vendimin nr. 421, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ne kërkojmë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që të marrë vendim për ndalimin e shpërndarjeve dhe angazhimit të të gjitha formave të postimeve të titullarëve, sepse gjatë kësaj periudhe shumica e postimeve të titullarëve lidhen dhe kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me fushatën zgjedhore. Faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit. Përfaqësues të shkollave dhe të zyrave vendore të arsimit parauniversitar, janë një pjesë e madhe prezent këtu besoj, apo të gjithë? Dëshiron dikush të diskutojë, në lidhje me çfarë është paraqitur në materialin denoncues nga organizata Qëndresa Qytetare, qëndrojnë apo nuk qëndrojnë ato pretendime.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. Enver Biturku:** Përshëndetje! Enver Biturku, drejtor i Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar, Kavajë. Fillimisht e falenderoj organizatën Qëndresa Qytetare për angazhimin e saj. Jemi njohur përpara disa ditësh nëpërmjet adresës elektronike për këto denoncime. Në vetëdijen tonë dhe duke verifikuar me kujdes provat e siguruara nga Qëndresa, fillimisht as ne si ZVA, as një nga shkollat nën juridiksionit tonë nuk është pjesë e provave. Ndoshta mund të jetë një ngatërrësë ose mosinformim i Qëndresës që jemi përfshirë edhe ne në këtë situatë. Kemi dhënë dy herë sqarime në emaile, por jemi thirrur edhe njëherë sot. Jemi të sigurtë dhe garantojmë se zyra arsimore dhe të gjitha shkollat që i takojnë qytetit të Kavajës nuk janë përfshirë pasi e njohin shumë mirë pjesën e legjislacionit dhe nëse përshihen mund të jenë adresa, apo llogari private, apo sa i takon aktiviteteve të shërbimit arsimor. Faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Po. Zotëria atje, po! Kërkuat të flisnit? Kërkuat fjalën më duket? Po.

**Z. Arben Seidi:** Përshëndetje, jam Drejtor i Shkollës “Ismail Janku”, i ZVAP, Bulqizë, i mirëkuptoj denoncimet që ka bërë organizata dhe dua të paraqes argumentet e mia si drejtues. Për një postim që ka bërë një administratore e shkollës sonë, që me argumentat që do të paraqes, dua që të vlerësohet se nuk ka absolutisht asnjë lloj prapavije politike, por thjesht një lapsus ose një gabim. Nuk ka qenë korrekte në zbatimin ligjor që e predispozon ligji. Unë doja të bëja një përshkrim të shkurtër, që nga ardhja ime aty si drejtues i kësaj shkolle. Kam ardhur në tetor të vitit 2017 dhe këtë faqe zyrtare që zotëron sot shkolla e kam gjetur të hapur përpara shumë viteve. Me ardhjen time jam interesuar se kush e administron këtë faqe. Mësova se administratori kryesor i faqes nuk është pjesë e sistemit arsimor por është një person i jashtëm ku paraardhësja ime kishte lidhje miqësore, në atë kohë nuk

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

kishte internet nëpër shkolla dhe aksesin për të hapur një faqe zyrtare e kishim pak njerëz. Për këtë arsye, unë i kam kërkuar më pas që të kishim një administrator nga shkolla për këtë faqe. Kemi pasur mësues që mbulonin aktivitetet kulturore artistike në shkollë, si dhe veprimtari të tjera për të pasqyruar veprimtaritë tona si shkollë. Ka qenë një mësuese tjetër disa vite, e cila u largua në SHBA para dy vitesh, dhe ne si drejtori kemi caktuar një mësuese tjetër për të administruar këtë faqe, së bashku me administratorin kryesor që thash më herët. Unë aktualisht nuk kam akses si drejtor në faqen zyrtare të shkollës. Këtë e kam bërë me vetëdije që unë të mos jem pjesë e pasqyrimin të asnjë lloj aktiviteti, por të jetë vetë shkolla që ta pasqyroj këtë gjë. Lidhur me postimin e fundit, që nga kjo organizatë është konsideruar politike, unë jam njoftuar nga zyra arsimore, sepse nuk kisha dijeni fare për këtë problem. Në mos gaboj, ditën e shtunë, jo të kësaj jave por të javës që ka kaluar, për një postim në rrjetet sociale, që unë e mora personale në fakt te faqja ime. Me sqarimet që më bënë e kuptova që ishte tek faqja zyrtare e shkollës. Atëherë mora në atë moment mësuesen administratore të faqes dhe mu tha, “nuk e di drejtor, por do ta shikoj dhe do të kthej përgjigje”. Pasi e pa, më tha “unë drejtor e kam bërë pa vetëdije, pa parë brendësinë e postimit”. Unë si drejtor i bëra vërejtjet e mia, kuptohet, thashë porosia ka qenë që çdo gjë do të jetë e kontrolluar. Në këtë moment ajo mori masat e veta mesa di unë, se akoma dhe sot nuk kam të drejtë që ta kontrolloj, e ka fshirë, dhe pas dy ditësh se u shty dhe shkolla se filloi pushimi në këtë periudhë për shkak të motit të keq. Ditën e mërkurë të javës së kaluar, filluam procesin mësimor dhe menjëherë mblodha komisionin e disiplinës dhe mësuesja kërkoi shumë falje për postimin që kishte bërë pa e kontrolluar. Mora masën e këshillimit dhe e zëvendësova me një administrator tjetër. Kjo është gjithë ngjarja tepër reale, e sinqertë që ka ndodhur, bashkë me mësuesen shkuam dhe në zyrën arsimore dhe atje dhamë sqarimet e nevojshme, mësuesja mori përgjegjësinë e saj dhe unë si drejtor shkolle. Ata na

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

dhanë masat e veta të këshillimit dhe kjo është e gjitha. Unë mendoj që kjo nuk paraqet një argument, që shkolla ime është marrë me pasqyrimin e aktiviteteve politike. Po të shohim veprimtarinë e shtatë viteve në mënyrë absolute nuk ka postime politike. Është një rast që është spontan, i pakontrolluar për momentin, se po të ishte që ne kemi vazhduar në këtë rrugë do të kishte përsëritje të tilla. Për sa kohë, që ky është një rast i veçuar dhe gabimisht pa e kontrolluar mësuesja, nuk mund ta quajmë se ishte me prapavijë politike. Mendoj se duhet të vlerësohet drejt dhe pa paragjykime. Nëse do të merremi pastaj jo po ky kështu, jo po ky ashtu do të shihni dhe diçka tjetër. Nëse do të shihni sikur edhe një postim të vetëm nga ana e drejtorit në faqen zyrtare të shkollës, unë jam i gatshëm që të marr çdo lloj përgjegjësie këtu përpara jush. Kjo do të thotë që unë në mënyrë absolute nuk zotëroj akses që të hyj në faqen zyrtare të shkollës. Unë kaq kisha, ju mirëpres edhe për pyetje çdo gjë që mund të keni dyshime.

**Z. I. Celibashi:** Ju faleminderit drejtor për shpjegimet tuaja. Mesa kuptova ju thatë që kjo ka ndodhur vetëm një herë, në mënyrë aksidentale dhe jeni të ndërgjegjshëm që në faqet zyrtare, në rrjetet sociale të shkollës nuk mund të ripublikohen mesazhe elektorale apo partiake të ministrit. Ata janë edhe figura politike dhe krahas aktivitetit të tyre publik zyrtar, kryejnë dhe aktivitet politik dhe je duke na thënë që e kupton shumë mirë që nuk lejohet që në faqet zyrtare sociale të shkollës të rishpërndahen mesazhe të karakterit politik, qoftë këto dhe të ministrit. Këtë thatë pak a shumë, apo jo?

Ka dikush tjetër që do të flasë?

**Znj. Semiramida Lulja:** Përshëndetje, jam Semiramida Lulja, drejtoreshë pranë Shkollës “Mustafa Greblleshi” në Tiranë. Menjëherë sapo jam njoftuar me email nga

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

zyra vendore arsimore, unë jam futur në llogarinë e shkollës dhe vërtet pashë që kisha bërë një like. Kjo është bërë pa vetëdije pasi në telefonin tim celular, që mund të vërtetohet shumë lehtë, mbaj dy llogari, atë personale dhe atë të shkollës që e administroj vetë. Ngatërresa është pa tendencë dhe ajo që dua të theksoj është që nuk jam as e shtyrë dhe as e ndikuar nga dikush që unë duhet të bëj postime të kësaj natyre. Unë për veprimin që kam bërë kërkoj ndjesë dhe ju garantoj që është bërë pa dashje, është vetëm një like, nuk është as një share i vazhdueshëm apo komente në vazhdimësi. Flas gjithmonë për përmbajtje politike. Kurse sa i përket angazhimeve të ministrisë në lidhje me arsimin, ne kemi bërë like vazhdimisht dhe do të vazhdojmë të bëjmë se ne i përkasim pjesës së arsimit dhe kjo s’do mend. Kaq.


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit. Dikush tjetër?

**Znj. Semiramida Lulja:** Faleminderit ju.

**Z. I. Celibashi:** Zotëria dëshiron të thotë diçka.

**Z. Lulëzim Lika:** Përshëndetje! Jam drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Klodian Tanushi” Tiranë. Ndodhem këtu sot për një koment që kam bërë në faqen zyrtare të shkollës. Personi që e ka bërë këtë koment kam qenë unë. Komenti ka qenë i tillë: “Për herë të parë diaspora ka të drejtën të votojë”. Në komentin tim nuk kam përmendur as Partinë Socialiste, as Partinë Demokratike, as ndonjë parti tjetër. Meqenëse ky koment ndoshta qenka kaq negativ dhe nuk duhej bërë në faqen zyrtare të shkollës, sinqerisht, unë kërkoj ndjesë dhe është hera e fundit që mendoj, se unë mund të bëj veprime të tilla.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. Lulëzim Lika:** As në mendje nuk e çoj të bëj një veprim të tillë, por edhe kjo që është bërë, është bërë thjesht për faktin pa pasur asnjë lloj indicie, apo ndonjë pikësynimi. Nuk e kuptoj sinqerisht, edhe pse jam tani përpara jush, se ku është e keqja e këtij lloj komenti, “Diaspora voton për herë të parë”. Nuk e di nëse Partisë Demokratike apo ndonjë partie tjetër i vjen e keqja nga kjo thënie, nuk arrij ta kuptoj. Megjithatë, e thashë, unë kërkoj ndjesë dhe, meqë është përdorur në faqen zyrtare të shkollës, që në atë moment unë kam hyrë dhe e kam fshirë komentin tim dhe nga kjo ditë premtoj që nuk do të bëj më komente në faqen zyrtare të shkollës, as *slide*, postime jo e jo, as kemi bërë dhe as e çojmë në mendje ta bëjmë.  
Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Nëse komenti që keni bërë në faqen zyrtare të KQZ-së ka qenë kaq e vetëm kaq, nuk ka asgjë të kritikueshme. E kritikueshme është që e keni fshirë atë komentin...

**Z. Lulëzim Lika:** E kam fshirë se më erdhi si provë.

**Z. I. Celibashi:** Nëse është kaq, edhe pse nuk është shumë e përshtatshme në atë faqe, por, gjithsesi, mesazhi i përcjellë ka qenë...

**Z. Lulëzim Lika:** Komenti im ka qenë: “Diaspora voton për herë të parë”, pa përmendur absolutisht asnjë parti politike në komentin tim.

**Z. I. Celibashi:** Me kaq ke qenë në rregull. Po, përfaqësuesi i Qëndresës.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. Dh. Zguro, jurist Qëndresa Qytetare:** Jemi të sigurt që disa prej institucioneve arsimore e kanë bërë prej ngatërresës për shkaqe të ndryshme, ndoshta për shkaqe detyrimi, megjithatë për të mos ngelur te fakti i komentit, sigurisht, vota e diasporës shumë e mirë, përgëzime që është arritur për herë të parë e suportojmë dhe advokojmë për votën e diasporës. Janë disa komente, në fakt, megjithatë ky koment është bërë në disa postime që lidhen tërësisht me përmbajtje politike dhe mënyrës sesi diaspora duhet të votojë, pra, “Takimi me komunitetin shqiptar në Athinë, për rëndësinë e votës historike të diasporës si kontribut për të vijuar rrugën pa kthim të Shqipërisë drejt familjes së madhe europiane. Nëse jeton jashtë Shqipërisë, regjistrohu në platformë. Voto për Partinë Socialiste. PS 2013 Për Shqipëri 2030...”

**Z. I. Celibashi:** Janë komentet që ka bërë zotëria, apo të tjerët?

**Z. Dh. Zguro, jurist Qëndresa Qytetare:** Natyra e postimit nga ana e ministres Manastirliu është një postim tërësisht politik, jo vetëm orienton, por tregon një mënyrë të caktuar vote dhe ky koment në vlerësimin tonë, komentet nuk mund të merren të shkëputura nga postimi...

**Z. I. Celibashi:** Kjo është e qartë. Ai zotëria thotë që nuk e ka shpërndarë dhe nuk i ka bërë *like* këtij komenti, që është siç thatë ju dhe ashtu qëndron. Ai thotë që për rastin e shkollës së tij, se ndoshta për shkolla të tjera mund të jetë kështu...

**Z. Lulëzim Lika:** Për rastin e shkollës “Klodian Tanushi” keni këtë koment: “Për herë të parë diaspora voton”. Mund ta verifikoni. Unë po e them sërish, nëse në këtë koment...

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. I. Celibashi:** E kemi të qartë, mos e zgjat më. Ka dikush tjetër që dëshiron të flasë në lidhje ...

**Z. A. Lugu:** Përshëndetje! Jam Artur Lugu, drejtor i shkollës “Ajosëm” në Shkodër. Jemi njohur dhe shqetësuar, në fakt, nga pretendimi i shoqatës për vënien në dispozicion të burimeve publike, angazhim online i titullarit të institucionit. E kemi ndjekur me të vërtetë me shqetësim se çfarë mund të kishte ndodhur. Ishte një *like* që administratori i shkollës i kishte bërë një postimi të ministres, e cila promovonte një studente ekselente të shkencave politike në Athinë, që ka dëshirë të pamatë për të kontribuar për Shqipërinë. Gjithsesi, në kuadrin e korrektësisë së institucionit, e konsideroj jo të nevojshme, ta heqim *like*-n, komunikova edhe me administratorin e *facebook*-un e shkollës, i cili m’u shpreh sinqerisht që nuk e kishte lexuar deri në fund postimin, por kishte vënë re faktin e kësaj studente ekselente, e cila dëshiron të kontribuojë. Sinqerisht, po bisedonim edhe me kolegët e tjerë për faktin që drejtorët e shkollave, të cilët angazhohen çdo ditë në institucione dhe japin një kontribut të jashtëzakonshëm, detyrohen të japin llogari për një *like* të vendosur nga administratori i shkollës, për të cilën ai ka shkruar edhe një imeil për ta justifikuar arsyetimin e tij me dëshirën e mirë për të dhënë secili prej nesh, edhe ne si drejtorë shkollash, kontributin tonë për një proces zgjedhor sa më transparent e korrekt. Dëshiroj të shpreh edhe shqetësimin për këtë moment që po diskutojmë së bashku në kuadër edhe të dëshirës për të bërë një *like* apo për të ecur përpara. Unë doja të vija në dukje edhe një gabim të shkresës së KQZ-së, të zotit Dhimitër Zguro, i cili, jam i sigurt njëmijë për qind, pa dashje shkruan: “Shkolla “Ajosëm” Drejtoria Rajonale Korçë, Zyra Vendore Poliçan, në një kohë që jemi në Shkodër. Po mendoja jo aq për të bërë paralele, por thjesht po mendoja se në punën tonë të përditshme momente shpejtësie apo momente pakujdesie të çojnë edhe në gabime, gabime, siç

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

e thashë, që me administratorin e faqes së shkollës, e kemi diskutuar, dhe ai ka bërë një shprehje personalisht për të justifikuar edhe veprimin, por të diskutojmë për një *like* më duket një peshë për mua sot. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Në dukje duket sikur është hiç asgjë, dhe nëse bëhet fjalë për një rast...

**Z. A. Lugu:** Një rast i vetëm, nuk është përsëritur asnjëherë, është e paqëllimshme.

**Z. I. Celibashi:** Parë edhe rrethanat e këtij rasti, ndoshta pretendimi juaj qëndron, por këtu jemi duke diskutuar për thelbin e gjësë. Ideja është që në faqet zyrtare të institucioneve publike, veçanërisht të institucioneve arsimore, është e ndaluar në mënyrë kategorike dhe kjo është çështje principi për standardin e zgjedhjeve, nuk mundet të gjejnë vend pëlqime apo mospëlqime për mesazhe politike të caktuara. Natyrisht, çfarë janë mesazhe që lidhen me aspektin funksional, me fushën e përgjegjësisë së këtyre institucioneve arsimore, të bëra këto nga vetë institucionet apo edhe nga Ministria e Arsimit, është e qartë që ndoshta keni edhe detyrimin t'i fuzioni, t'u jepni eko mesazheve të kësaj natyre, por jo atyre politike. E kuptoj që ju të gjithë jeni koshientë për këtë dhe e keni kuptuar që në një mënyrë ose në një tjetër kjo nuk duhet të ndodhë dhe jeni duke pretenduar e justifikuar që diku pa dashje, dikush nga mungesa e vëmendjes, pa e lexuar komplet mesazhin e përcjellë nga ministria apo ministri.

Po, përfaqësuesi i Qëndresës.

**Z. Dh. Zguro, jurist Qëndresa Qytetare:** Së pari, duke qenë se vij nga familje mësuesish, më vjen keq që drejtorët e shkollave, mësuesit duhet të vijnë këtu e të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

përballen në lidhje me shpërdorimin e burimeve publike. Gjithashtu, së dyti, për sa i takon lapsusit që zotëria përmendi, po është një lapsus që ka dy shkolla me të njëjtin emër në vende të ndryshme, prandaj ka qenë kjo ngatërresë fillimisht, megjithatë, për sa i takon pretendimit për një *like*, për një koment apo për një *share*, është realisht në nivelin e qesharakes për t'u marr me faktin nëse përdoret, pra nëse bëhet *like*, *share* apo koment, megjithatë thelbi qëndron në parim dhe në mos shpërdorimin e burimeve publike. Edhe pse në disa raste disa prej ZVA-ve apo drejtorive rajonale kanë pretenduar që faqet nuk përbëjnë burime publike, mjafton fakti që po vendosim prestigjin e institucionit në diskutim, duke iu referuar edhe parimeve të Komisionit të Venecies, atëherë kemi të bëjmë me një shkelje. Gjithashtu, doja të theksoja edhe gjënë tjetër. "Qëndresa qytetare" ka përcjellë vetëm disa prej provave apo disa prej rasteve duke qenë 3-4 raste maksimalisht deri në datën e denoncimit, por nëse do të hyhet sot në faqen e ministres së Arsimit, do të shikohet që ndoshta potencialisht edhe disa prej shkollave që mund të jenë bërë në këtë denoncim, nuk dua t'i nominoj individualisht për shkak se më pas më duhet të referoj dhe tek provat dhe do të merrte më shumë kohë për efekt të hetimit administrativ, megjithatë kjo është një çështje sistematike. Shqetësimi ynë thelbësor, siç e theksova edhe një herë, është te mënyra sistematike sesi shkollat përdoren si burime publike dhe vihen në dispozicion të një partie. Nuk ka rëndësi sesi është kjo vendosje në përdorim ose në favor të një partie politike, mjafton vetëm fakti që ato janë përdorur, nuk ka asnjë lloj rëndësie sesi është vendosur, është vendosur shkolla në dispozicion për të xhiruar një aktivitet elektoral brenda shkollës, në oborr të shkollës, është vendosur në faqen e institucionit, kjo nuk asnjë lloj rëndësie për ligjin. Për sa kohë shkolla është një burim publik, është e ndaluar të përdoret dhe për këtë duhet të jenë të gjithë të qartë jo vetëm institucionet arsimore, por edhe institucionet e kujdesit shëndetësor dhe të gjitha institucionet në Shqipëri. Ndaj ne e ritheksojmë edhe një herë faktin që

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

vendimi të ketë kuptim duhet të ndalohen të gjitha institucionet arsimore dhe jo vetëm, institucionet publike për të shpërndarë postimet e titullarëve të tyre, sepse shumica e postimeve në këtë periudhë janë postime me përmbajtje elektorale.

Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po.

**Znj. Mira Koleci:** Përshëndetje! Unë jam juristja e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë. Quhem Mira Koleci. Edhe unë jam vajzë e dy prindërve mësues. Unë garantoj avokatin që nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë kurrë nuk u është dërguar asnjëherë drejtuesve të shkollës, përderisa jemi edhe palë e thirrur këtu, kërkesë ose detyrim që të postojnë gjëra me përmbajtje elektorale, në radhë të parë. Në radhë të dytë, garantoj që tri rastet e *like*-ve të drejtuesve të shkollës janë totalisht pa dashje, sepse po ta marrim hollë-hollë, secili prej nesh nëse fillojmë e postojmë gjërat, marrim më shumë *like* ose komente nga adresat tona personale, sesa po t'i bëjmë nga adresat e shkollave. Unë personalisht merrem me median e institucionit tonë dhe më shumë klikime kam në adresën time personale sesa nga institucioni ynë.

**Z. I. Celibashi:** Shumë mirë, bëni nga personalet, pse i bëni nga...

**Znj. Mira Koleci:** Nuk kemi bërë as nga personalet, as nga ato të institucionit, por sidoqoftë...

**Z. I. Celibashi:** Dikush tjetër do të flasë? Po.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 21.01.2025*

**Z. Dh. Zguro, jurist Qëndresa Qytetare:** Dua të shtoj diçka. Në asnjë moment “Qëndresa qytetar” e nuk ka pretenduar që ZVA-të apo drejtoritë rajonale kanë urdhëruar, detyruar institucionet që në varësi për të shpërndarë postime me përmbajtje politike, për aq kohë sa ne nuk kemi një provë për ta provuar këtë gjë, megjithatë, në vlerësimin tonë, duke iu referuar edhe ligjit për arsimin parauniversitar dhe të gjitha akteve nënligjore, këto institucione kanë detyrim të monitorojnë ligjshmërinë e veprimtarisë së këtyre institucioneve. Vetëm për këtë fakt institucionet janë bërë pjesë e këtij denoncimi. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Kemi diskutime të tjera në lidhje me këtë çështje? Nuk kemi. Dokumentacion shtesë dikush do të depozitohet përveç atyre që mund të ketë sjellë me imeil ose në mënyrë tjetër në KQZ? Jo.

E përfundojmë hetimin administrativ në lidhje me këtë denoncim. Vendimin në lidhje me këtë çështje e shpallim ditën e premte të kësaj jave. Njoftojini të gjithë për orën e shpalljes së vendimit. Përtej kësaj, ajo çka vlen ta them në mbyllje të kësaj seance, marr shkak nga ato që tha përfaqësuesi i Qëndresës, që zyrat vendore do të duhet të tregojnë të gjithë kujdesin në aspektin e mbikëqyrjes ndaj sjelljes dhe veprimit të institucioneve arsimore publike, me qëllim që të mos bëhen shpërndarës të mesazheve politike, përfshirë këtu edhe të ministrit.

Seanca mbyllet.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen.

Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



1 . Jetmir Çaushti Has	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
2. Elira Smakaj Shkodër	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
3. Artur Lugu - Shkodër	- Drejtor , Shkolla “ Ajosëm “	-
4. Marjus Gjata Patos	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
5. Erinda Këreci Gjirokastër	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
6. Matilda Gushi Gjirokastër	- Drejtor , Shkolla “ Pandeli Sotiri “	-
7. Albano Xhemaj Frashër , Patos	- Drejtor , Shkolla “ Koli Dino “	-
8. Odeta Gjini Fier	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
9. Klea Shahini Kamëz	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
10. Lumturie Kurti Kamëz	- Drejtor , Shkolla “ Fatos Lame “	-
11. Petrit Lica Bulqizë	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
12. Arben Seidi Bulqizë	- Drejtor , Shkolla “ Ismail Janku “	-
13. Marisa Jakoj Lezhë	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
14. Enrida Xhepollari Durrës	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
15. Jetnor Kalaja Pogradec	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
16. Eduart Gjini Pogradec	- Drejtor , Shkolla “ Shahin Kullolli “	-
17 .Semiramida Luli Tiranë	- Drejtor , Shkolla “ Mustafa Greblleshi	-
18 . Lulzim Lika Tiranë	- Drejtor , Shkolla “ Klodian Tanushi “	-

19. Antigona Rexha Fushëarrëz	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	- Pukë -
20. Viktor Lleshi Fushë-Arrëz	- Drejtor , Shkolla " Mark Jaku "	-
21. Vesa Liço Elbasan	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
22. Anila Isaku Tiranë	- Drejtor , Shkolla " Kristoforidhi "	-
23 . Nazmi Sula Belsh	- Drejtor , Shkolla " Jashar Dunga "	-
24. Mehmet Dervishi	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	- Belsh
25. Arbër Masupaj	- Agjensia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar	- Tiranë
26. Ervin Maho Pogradec	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
27. Mateus Sufko Roskovec	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
28. Burbuqe Sufko Roskovec	- Drejtor , Shkolla " Alush Grepcka "	-
29. Elis Kaçani Rrogozhinë	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare	-
30 . Enviol Dhimo	- Shkolla " 9 Vjeçare " - Spille	
31. Enver Biturku	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare - Kavajë	
32. Rea Koleci	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare - Tiranë	
33. Josif Kurti	- Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare - Divjakë	
34. Liri Bitri	- Drejtor , Shkolla " Koli Sako " - Divjakë	